

UDHËZIM
Nr.32, datë 21.10.2010

**PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE FITUES NË CIKLIN E PARË TË
STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË
LARTË PËR PLOTËSIMIN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA, PËR VITIN
AKADEMIK 2010-2011**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 33 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr.586, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimiit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2010-2011”, të ndryshuar, të vendimit nr.503, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe të vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Të regjistrohen në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve, sipas programeve përkatëse të studimit, kandidatët që shpallen fitues nga kuotat e parealizuara, pas përfundimit të regjistrimeve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë.

2. Kandidatët që aplikojnë vetëm për vendet e shpallura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në tabelën bashkëngjitur vendimit nr.586, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimiit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2010-2011”, të ndryshuar.

3. Kandidatët fitues përcaktohen nga Agjencia Kombëtare e Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë (APRIAL), në bazë të dy parimeve:

a) Parimi i meritës: sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme dhe provimeve të “Maturës Shtetërore”.

b) Parimi i vullnetit të kandidatëve, i shprehur nëpërmjet preferencës më të lartë të zgjedhur prej tyre në formularin A3.

4. Kanë të drejtë të plotësojnë formularin A3 të gjithë kandidatët, të cilët kanë plotësuar formularin A2 dhe:

a) nuk kanë mundur të përfshihen në listat e fituesve për t’u regjistruar në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2010-2011;

b) janë përfshirë në listat e fituesve dhe nuk janë regjistruar në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2010-2011.

5. Formulari A3 përmban të gjitha kuotat për secilin program studimi, të përcaktuara në tabelën bashkëngjitur vendimit nr.586, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimiit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2010-2011”, të ndryshuar dhe mundëson orientimin për aplikim në programet e studimit, të preferuara nga kandidati, në bazë të pikëve të fituara dhe të pikëve të fituesit të fundit.

6. APRIAL-i të shpërndajë formularin A3 në DAR/ZA-të më 21.10.2010.

7. DAR/ZA-të ta shpërndajnë formularin A3 në shkolla në datën 22.10.2010 deri në datën 23.10.2010.

8. Kandidatët/maturantët e përcaktuar në pikën 4 ta tërheqin formularin A3 në shkollat respektive ku kanë tërhequr formularin A2 dhe ta kthejnë atë të plotësuar me preferencat e tyre

brenda datës 27.10.2010.

9. Drejtoritë e shkollave t'i dorëzojnë formularët A3, të plotësuar dhe të paplotësuar me procesverbal pranë DAR/ZA-ve përgjegjëse, brenda datës 27.10.2010.

10. DAR/ZA-të t'i dërgojnë në APRIAL formularët A3 në datën 28.10.2010.

11. APRIAL-i të përpunojë të dhënat e marra nga formularët A3 dhe në datën 4.11.2010 të shpallë listën përfundimtare të kandidatëve fitues, të ndarë sipas programeve përkatëse të studimit, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve dhe sipas preferencës më të lartë të kërkuar prej tyre në formularin A3, në përputhje me kuotat e rishpërndara dhe njëkohësisht ta dorëzojë këtë listë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

12. APRIAL-i të dorëzojë, në datën 4.11.2010, në formë të shkruar dhe elektronike, listat përfundimtare të kandidatëve fitues, sipas programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ZA-të. Këto institucione të afishojnë menjëherë listat në vende të dukshme në mjediset e tyre.

13. Regjistrimi i kandidatëve fitues të bëhet pranë sekretarive mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë në datat 5, 6, 7, 8 nëntor, nga ora 8.00 deri në orën 18.00. Për regjistrim, kandidati duhet të dorëzojë dosjen individuale, me dokumentet origjinale të mëposhtme:

a) Dëftesë pjekurie (në mungesë, listë notash me fotografi, të nënshkruar nga drejtori i shkollës dhe nga drejtori i drejtorisë arsimore rajonale/drejtori i zyrës arsimore, ose listë notash të lëshuar nga Arkivi i Shtetit);

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë) origjinalin dhe fotokopjen e tij. Në dosje të mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit, në mungesë të tyre, kandidati dorëzon certifikatën personale me fotografi;

c) 2 fotografi;

ç) Mandat-arkëtimi të tarifës së regjistrimit prej 1550 lekësh të lëshuar nga bankat e nivelit të dytë, në Shqipëri.

14. Në kryerjen e procedurës së regjistrimit të kandidatëve fitues, sekretaritë mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë të regjistrojnë studentët në regjistrin bazë të studentëve, në bazë të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit".

15. Sekretaria mësimore të pajisë kandidatin me fletë-regjistrimi, ku të shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, data dhe ora e regjistrimit. Fletë-regjistrimi duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga titullari i institucionit publik të arsimit të lartë/i njësisë kryesore që kryen regjistrimin dhe nga kryesekretari mësimor.

16. Për kandidatët/maturantët që e kanë likuiduar tarifën e regjistrimit në një nga fazat e regjistrimit me formularin A2, nuk është e nevojshme të bëjnë pagesë të re. Tarifa e regjistrimit prej 1550 lekësh, e arkëtuar nga kandidati/maturanti në fazat e mëparshme, të kalojë me xhirim nga llogaria e degës së thesarit, ku institucioni publik i arsimit të lartë ka llogarinë buxhetore, në llogarinë e thesarit të institucionit tjetër publik të arsimit të lartë, në të cilin është realizuar regjistrimi përfundimtar i kandidatit/maturantit me formularin A3.

17. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në APRIAL listat përfundimtare origjinale, të përgatitura nga APRIAL-i, me regjistrimet e kryera, në formë të shkruar dhe elektronike, brenda datës 10.11.2010.

18. Institucionet publike të arsimit të lartë, nga data 4.11.2010, të shpallin në vende të dukshme, në mjediset e tyre, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të domosdoshme për regjistrim, si edhe të dhëna të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë.

19. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

20. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, APRIAL-i,

institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ZA-të.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj